



“Manaxhimi i Integruar i Mbetjeve Urbane në Qytetin e Tiranës”

Tryezë e Rrumbullakët për Prezantimin e Studimit të Fizibilitetit për Manaxhimin e Integruar të Mbetjeve në Qytetin e Tiranës

Datë 29 Tetor 2014, Ora 9:30 - 12:30

Salla “Magna Aula”, Universiteti POLIS





Konteksti Aktual i Manaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane

Manaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta Urbane (MMNU) paraqet një nga problemet më të rëndësishme dhe më serioze, me të cilat aktualisht përballet vendi. Ndonëse kuadri ligjor për manaxhimin e integruar të mbetjeve gjatë viteve të fundit është përmirësuar ndjeshëm, duke parashikuar qartë në legjislacion mënyrat e procesimit të rrymave kryesore të mbetjeve dhe alternativat për trajtimin përfundimtar të mbetjeve, rezultatet konkrete në këtë sektor kanë qenë të pamjaftueshme, të pakoordinuara, ku mundësitë e njësive vendore kanë qenë të limituara për të përmbushur targetet e kërkuara nga politika kombëtare.

Sot shërbimi i MMNU-së ofrohet ose nga ndërmarjet bashkiake ose nga kompani private të kontraktuara nga vetë NjQV-të. Sistemet kryesore për manaxhimin e mbetjeve konsistojnë në grumbullimin e MNU-ve në një rrymë të vetme në Pikat e Grumbullimit të Mbetjeve (PGM), të përbërë nga kontenerë të përbashkët dhe transportimin e tyre, pa asnjë trajtim, drejt vendeve të grumbullimit që janë nën administrimin e vetë njësive lokale, të cilat operojnë jashtë kushteve higjieno sanitare, me përjashtim të landfillit të Sharrës dhe Bushatit. Ndonëse ka një potencial të konsiderueshëm për riciklimin apo kompostimin (50% deri në 60%), ndarja e mbetjeve në burim pothuasje nuk ekziton dhe aktivitetet e grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme janë sporadike, në nivele të ulta dhe jo të organizuara. Buxheti për manaxhimin e mbetjeve në NJQV-të realizohet nga të ardhurat nga tarifa e pastrimit, të ardhura të tjera vendore, si dhe nga transfertat e pakushtëzuara nga qeveria qendrore. Sot kostot e operimit dhe mirëmbajtjes nuk mbulohen nga të ardhurat e gjeneruara nga tarifa e pastrimit, duke rezultuar në ofrim e një shërbimi aspakt të qëndrueshëm dhe eficient. Nisur nga kuadri aktual ligjor, niveli i tarifave miratohet nga Këshillat Bashkiak dhe të Komunave për kategoritë e konsumatorëve, si një shumë fikse, e cila ndonëse tenton të reflektojë standardin ekonomik të njësisë respektive, në nivel konsumatori nuk reflekton as madhësinë, as sasinë e mbetjeve të gjeneruara, apo shërbimet e mbetjeve që i ofrohen.

Bashkia Tiranë, njësia vendore me numrin më të madh të popullsisë në vend, gjeneron 230,000 ton mbetje në vit, të cilat grumbullohen dhe transportohen nga 6 kompanitë e kontraktuara, dhe depozitohen në landfillin e Sharrës, i cili manaxhohet nga vetë bashkia. Ndonëse potenciali për riciklimin e mbetjeve që shkojnë në landfill përbën 40% të rrymës



totale të mbetjeve (plastikë, letër, qelq dhe metale), ndarja e mbetjeve në burim pothuajse nuk ekziton. Buxheti vjetor i Bashkisë Tiranë për shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve vlerësohet të jetë rreth 7.5 million EURO në vit. Nga të dhënat e Bashkisë, të ardhurat e mbledhura nga tarifa për konsumatorin familjar dhe bizneset në vitin 2012, kanë mbuluar rreth 84% të kostos së shërbimit. Ndërsa të dhënat e vitit 2013 tregojnë një rritje të nivelit të grumbullimit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit për konsumatorin familjar dhe bizneset me 10%. Nga këto të dhëna kuptojmë që Bashkia Tiranë nga njëra anë ka një potencial të konsiderueshëm riciklimi, i cili nuk shfrytëzohet për mbullimin e kostos, dhe nga ana tjetër të ardhurat e mbledhura nuk mbulojnë plotësisht koston e shërbimit.

Nisur nga fakti, që sot njësitë vendore kanë si sfidë mbulimin e plotë të kostos nga të ardhurat e mbledhura nga tarifat, në rastin konkrete shtrohet natyrshëm çështja për diskutim, se cila nga zgjidhjet do të ishte më e përshtatshme për Bashkinë Tiranë për mbulimin e plotë të kostos: diversifikimi i shërbimeve për manaxhimin e mbetjeve, apo rritja e tarifës kundrejt konsumatorëve?

Në këtë kontekst, gjatë vitit 2013 Bashkia Tiranë në bashkëpunim IFC, në kuadër të projektit “Projekti për Partneritetet Publike Private për mbetjet e ngurta në qytetin e Tiranës”, realizoi një studim fizibiliteti për të kuptuar gjendjen ekzistuese të sistemit të manaxhimit të mbetjeve dhe për të propozuar zgjidhjet më të përshatshme për një manaxhim sa më të integruar të mbetjeve

Nisur nga ky fakt, Co-PLAN në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë dhe IFC, në kuadër të projektit ENV.net financuar nga BE, organizojnë Tryezën e Rrumbullakët Manaxhimi i Integruar i Mbetjeve Urbane në Qytetin e Tiranës, e cila synon prezantimin e studimit të fizibilitetit që është kryer për manaxhimin e integruar të mbetjeve në qytetin e Tiranës, dhe për të hapur një diskutim me aktorët e interesit, organizatat e shoqërisë civile dhe bizneset për të diskutuar zgjidhjet më të përshtatshme për manaxhimin e integruar të mbetjeve urbane në qytetin e Tiranës.



Programi i Tryezës

9:30 – 10:00	Regjistrimi i Pjesëmarrësve
10:00 – 10:10	Fjala e Hapjes – Moderimi nga Z. Dritan SHUTINA, Drejtor Ekzekutiv i Co-PLAN
10:10 – 10:30	Fjala e Kryetarit Bashkisë Tiranë Z. Lulzim BASHA – Sistemi i manaxhimit të mbetjeve në qytetin e Tiranës
10:30 – 11:15	Prezantimi i Studimit të Fizibilitetit për Manaxhimin e Integruar të Mbetjeve, Përfaqësues i IFC
11:15 – 12:15	Diskutim i Hapur me Pjesëmarrësit
12:15	Bufe